



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2019  
Nr. Dok. 201802439/2

**Lënda:** *Rekomandime lidhur me përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e të paburgosurve/dënuarve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Vaqarr, Tiranë.*

**Drejtuar:** **Z. Agim ISMAILI**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve**

**TIRANË**

**Z. Petrit MYSLYMI**  
**Drejtor**  
**Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr**

**TIRANË**

*Të nderuar zotërinj,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar<sup>1</sup>, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr, Tiranë, më datë 03.12.2018, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi dhe z.Alfred Koçobashi me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi kryesor i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr, në kuadër të respektimit të të drejtave dhe trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim të përcaktuara në ligjin nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar, garantimin e të drejtave të këtyre personave të parashikuara në dokumentet ndërkombëtare, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Vizita u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi dhe sipas procedurës të zhvillimit të inspektimit në këto institucione. Grupi i inspektimit u takua fillimisht me z.Petrit

<sup>1</sup> Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

Myslymi, Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr dhe shefat e sektorit sipas seksioneve të kësaj drejtorie, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Nga ana e drejtuesit të institucionit, grupit të inspektimit iu ofrua mundësia që të kishin akses në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, për zhvillimin e takimeve dhe intervistave konfidenciale me personat e paraburgosur/dënuar, si dhe inspektimin e ambienteve të banimit dhe ambienteve të përbashkëta, që ishin objekt i monitorimit.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

### **Shënime paraprake**

Vizita inspektuese e Mekanizmit Kombëtar pranë Avokatit të Popullit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr, për vitin 2018 u krye në përputhje me metodologjinë e inspektimeve të burgjeve.

Në takimin me drejtuesin e Institucionit, grupi inspektues kërkoi fillimisht një informacion në lidhje me situatën e respektimit të të drejtave dhe trajtimin e të paraburgosurve/dënuarve në këtë institucion, mënyrën e trajtimit të kërkesë/ankesave, vënien në dispozicion të dokumentacionit në lidhje me strukturën, organikën dhe aktivitetin e sektorëve juridik, psiko-social dhe shërbimit shëndetësor, si dhe për masat e marra në zbatim të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Sipas informacionit, bazuar në urdhërin nr.329, datë 15.01.2009 të Ministrit të Drejtësisë “*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*”, i ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr, ishte i klasifikuar si “institucion paraburgimi”.

Ndërkohë, me urdhërin nr.8927/1 datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë “*Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*”, ky Institucion klasifikohet si “burg i sigurisë së ulët”, me një seksion siguri e ulët dhe një seksion burg i hapur për të dënuarit me vendim gjykate (gjysëm liri).

Sipas informacionit rezultoi se, kapaciteti fizik i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr ishte për akomodimin e 140 personave të paraburgosur. Në datën e inspektimit, në mjediset e këtij institucioni numri i personave të paraburgosur dhe të dënuarve ishte 154 persona, nga të cilët 153 të paraburgosur dhe 1 i dënuar, me mbipopullim prej 14 personash mbi kapacitet. Në këtë institucion ishin 6 të paraburgosur të cilët i përkisnin kategorisë 18-21 vjeç të vendosur në seksion të veçantë për këto moshë, 6 persona të sëmurë mendorë dhe 9 persona që ishin diagnostikuar me sëmundjen e diabetit.

Nga informacioni në takimin me drejtuesin dhe stafin e institucionit, inspektimi i ambienteve në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm të këtij Institucioni, si dhe intervistat konfidenciale të zhvilluara me personat e privuar nga liria, rezultoi se kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

1. në ambientin e observim/veçimit nuk ndodhej asnjë person i paraburgosur për arsye të mospërshtatjes, pasi ishin transferuar në ambientet e banimit;
2. sektori psiko-social kishte hartuar program të veçantë për trajtimin me të rinjtë e moshës 18-21 vjeç;
3. në ambientin e observim/veçimit ishin përmirësuar kushtet materiale dhe higjieno-sanitare;
4. organika e Institucionit ishte plotësuar në sektorin e çështjeve shoqërore, duke punësuar një punonjës me profesion psikolog;
5. dhomat e banimit ishin të lyera dhe tualetet ishin të kompletuara me dushe dhe me aksesoret përkatës;
6. ishin marrë masat për rregullimin e menaxhimit të procesit të kërkesë/ankesave dhe vënien në funksion të kutive postare në seksione.
7. shërbimi i lavanderisë për larjen e ndërresave personale ishte përmirësuar;
8. një pjese e ambientit të ajrimit, ishte e mbuluar dhe mundësonte ajrimin e të paraburgosurve në ditët me kushte të këqia atmosferike;

Ndërkohë, pjesa tjetër e rekomandimeve ende nuk kishin gjetur zbatim. Më konkretisht:

1. Vazhdonte problemi i mbipopullimit në raport me kapacitetin zyrtar, gjë që cenon të drejtën për hapësirë jetike për person.
2. Institucioni kishte probleme me furnizimin me ujë i cili ishte jashtë standardit, për shkak të amortizimit të rrjetit të ujësjellësit;
3. në disa nga ambientet e banimit kishte lagështirë, për shkak të mungesës të hidroizolimit të tarracës së godinës;
4. autoambulanca e institucionit nuk ishte pajisur me mjetet e nevojshme mjekësore për dhënien e ndihmës së shpejtë;
5. në ambientet e kuzhinës të institucionit mungonte pajisja për aspirimin dhe ventilimin e ajrit;

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e kushteve të jetësës të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr, u informuam se kjo situatë ishte për shkak të mungesës të fondeve dhe të investimeve të kryera në vite. Nga ana e drejtorisë së institucionit, për nevojat e planifikimit të projekt buxhetit dhe investimeve për vitin 2019, ishin dërguar dy shkresa zyrtare Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve<sup>2</sup>, në të cilat kërkohej rikonstruksioni (hidroizolimi) i plotë i tarracës të godinës ku kryejnë dënimin të paraburgosurit, si dhe marrjen e masave për eliminimin e lagështirës në ambientet e saj. Sipas informacionit, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ishte premtuar kryerja e rikonstruksionit të tarracës të godinës së banimit të paraburgosurve për vitin buxhetor në vijim.

## **1. Trajtimi**

Grupi i inspektimit, për mbledhjen e informacionit në lidhje me trajtimin e të paraburgosurve/dënuarve dhe respektimin e të drejtave të tyre të parashikuara në aktet normative në fuqi, zhvilloi intervista me stafin e institucionit dhe me personat e paraburgosur, si dhe inspektoi ambientet e dhomave për jetesë dhe ambientet e përbashkëta të këtij Institucioni.

Qëllimi i inspektimit ishte identifikimi i rasteve të ushtrimit të torturës, të dhunës fizike ose psikologjike, apo të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar në aktet

<sup>2</sup> Shkresë nr.1029 prot., datë 08.08.2018 dhe shkresë nr.1029/1 prot., datë 22.10.2018.

normative në fuqi ndaj kësaj kategorie personash, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore ndaj tyre. Nga informacioni i marrë gjatë bisedave konfidenciale dhe intervistave të bëra me të paraburgosurit dhe të dënuarit rezultoi se nuk kishte raste torture, të dhunimit fizik ose psikologjik apo të përdorimit të tepruar të forcës fizike ndaj tyre nga personeli i sigurisë dhe ai civil që shërben në këtë institucion.

Në intervistat konfidenciale me të paraburgosurit/dënuarit, ata ngritën ankesa që kishin të bënin me nevojën e një prezence më të madhe të juristit dhe të stafit psiko-social të institucionit në takimet periodike që zhvillojnë në çdo seksion, për dhënien e këshillimeve ligjore dhe sqarimeve të nevojshme në lidhje me të drejtat që iu jep ligji në rastin e kërkesave për transferime dhe lejeve shpërblyese, si dhe nevojën e respektimit të këtyre të drejtave nga ana e stafit dhe punonjësit e policisë të institucionit.

Një shqetësim tjetër i ngritur edhe në inspektimet e mëparshme nga të paraburgosurit, ishte problemi i furnizimit me ujë të rrjedhshëm që përdorej për larjen e trupit dhe pastërtinë higjieno-sanitare të ambienteve, pasi uji që vinte nga rrjeti i ujësjellësit dhe furnizonte këtë Institucion, vazhdonte të ishte i turbullt dhe nuk mund të përdorej.

Ankesa nga personat e paraburgosur/dënuar u ngritën dhe për sa i takon shërbimit shëndetësor, në lidhje me vizitat e vonuara nga stafi mjekësor i këtij institucioni.

Nga inspektimi i ambienteve dhe intervistat me të paraburgosurit, doli si problematikë shqetësuese niveli i lartë i lagësirës në disa nga ambientet e banimit, si dhe në ambientet e tualeteve dhe të dusheve, kjo për shkak të mungesës së izolimit të plotë të tarracës të godinave të banimit.

Grupi monitorues inspektoi situatën e trajtimit, kushteve materiale dhe ato higjienike të paraburgosurve/dënuarve në ambientet e observim/veçimit. Ambienti ishte i lyer, i pastër nga ana higjieno-sanitare dhe dhomat ishin të plotësuara me pajisjet e domosdoshme për të përmbushur nevojat kryesore të jetesës, si tavolina, stola dhe komodina.

Në ditën e inspektimit në ambientin e observim/veçimit, ishin 3(tre) persona, nga të cilët njëri prej tyre ishte me kërkesën e tij për mospërshtatje, për shkak të orientimit seksual ndryshe (homoseksual) dhe dy të tjerë të ndëshkuar me masë disiplinore.

Në 40 nga dhomat e destinuara për banim të paraburgosurve, 34 prej tyre ishin të pajisura me lavamanë dhe dushe brenda në dhoma. Veç tyre, për çdo sektorë kishte dhe ambiente të përbashkëta që shërbenin si tualete dhe dushe për larjen e trupit.

Marrëdhëniet ndërmjet personelit të Institucionit dhe të paraburgosurve e të dënuarve ishin korrekte dhe nuk pati ankesa nga këta të fundit.

Organika e institucionit ishte e plotësuar dhe nuk kishte mungesë stafi në sektorët kryesorë që ofrojnë shërbimet bazë si për ruajtjen dhe sigurinë e institucionit, në sektorin juridik, sektorin psiko-social, shërbimin mjekësor dhe në personelin e guzhinës.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr në momentin e inspektimit nga 25 të paraburgosur të punësuar në organikë, ishin të punësuar 22 të paraburgosur kryesisht në kuzhinë, pastrim, gjelbërim, shpërndarje ushqimi, bibliotekë dhe magazinë. Sipas informacionit të drejtuesit të Institucionit, me të paraburgosurit e punësuar nuk ishin lidhur kontrata pune që rregullojnë marrëdhëniet e punës, pasi me marrjen e vendimit nga gjykatat këta persona menjëherë ose lirohen ose transferohen për në Institucionet e tjera penitenciare. Në gjykimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, mungesa e lidhjes të kontratës të punës me të paraburgosurit e punësuar, është shkelje e një të drejte e

saksionuar në aktet ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe, por kryesisht në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve përcaktohet se *“Të paraburgosurit apo të dënuarit kanë të drejtë të punojnë në përputhje me aftësitë fizike, shëndetësore dhe psikologjike .....Aktet ligjore dhe nënligjore që shërbejnë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, mirëqenies sociale dhe kohëzgjatjen e punës, si dhe ato që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me përjashtim të ushtrimit të së drejtës për grevë dhe pjesëmarrje në sindikata, zbatohen njëjloj edhe për të paraburgosurit e të dënuarit”*<sup>3</sup>.

Nisur nga ky konstatim, sjellim gjithashtu në vëmendje se punësimi i të paraburgosurve/dënuarve rregullohet sipas neneve 34, 35 të ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, i ndryshuar<sup>4</sup> dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve<sup>5</sup>.

Avokati i Popullit, duke vlerësuar punësimin e të paraburgosurve/dënuarve si një e drejtë e ligjshme, ka bërë disa rekomandime Ministrit të Drejtësisë për miratimin e akteve nënligjore që rregullojnë të drejtën e punësimit në këto institucione. Rekomandimet janë vlerësuar të drejta, por kanë kaluar më shumë se 10 vite dhe ato nuk janë miratuar tej çdo afati ligjor.

## **2. Masat mbrojtëse.**

Nga kontrolli i dokumentacioneve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr, lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se, çdo kërkesë/ankesë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej<sup>6</sup>. Regjistri për regjistrimin e kërkesë/ankesave ishte i sekretuar dhe administrohej nga sekretaria e institucionit. Të paraburgosurit/dënuarit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe e hidhnin në kutinë postare ose ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social.

Në rastin kur kërkesë/ankesat i drejtoheshin drejtuesit të Institucionit, punonjësi i sektorit psiko-social i dërgonte ato në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim ose merrte takim me vetë të paraburgosurit. Në regjistrin e kërkesë/ankesave ishte e pasqyruar me shkrim se nga cili anëtar i stafit merrej ajo, mënyra e trajtimit dhe e zgjidhjes së saj.

Në zbatim të kërkesave të nenit 56 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM-në nr. 437, datë 20.05.2015 dhe rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm në këtë Institucion, të paraburgosurit e grup moshës 18-21 vjeç ishin të akomoduar në seksion të veçantë dhe për trajnimin e tyre më vete kishte një program psiko-social. Po ashtu, aktivitetet e përbashkëta zhvilloheshin në orare të ndryshme nga personat e tjerë madhorë.

Grupi inspektues, mori informacion për rregullat e pritjes të të paraburgosurve në institucion dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes, si dhe për mënyrën e plotësimit të regjistrave e dosjeve personale të tyre. Nga biseda me drejtorin e institucionit dhe nga verifikimet e dosjeve, grupi monitorues konstatoi se procedura e pranimit në institucion

---

<sup>3</sup> Neni 54, Kreu XII, Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.

<sup>4</sup> Nenet 76 dhe 77 të ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, i ndryshuar.

<sup>5</sup> Nenet 54/3 dhe 54/4/a të Rregullores të Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr. 437, datë 20.05.2015

<sup>6</sup> Neni 49 i ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, i ndryshuar.

zbatohet në mënyrë korrekte. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit, rezultoi se veprimet e pranimit regjistroheshin në regjistrin përkatës të hapur nga ky institucion.

Institucioni mbikqyret nëpërmjet sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi, të cilat ishin vendosur në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit. Monitorimi kryhet për 24 orë, ndërsa filmimi ruhet për dy javë. Qartësia e pamjeve të kamerave të sigurisë ishte e mirë.

Kontakti i të paraburgosurve dhe i të dënuarve me botën e jashtme realizohej nëpërmjet takimeve me familjarët, të cilat zhvilloheshin rregullisht. Për realizimin e kësaj të drejte në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr kishte dy ambiente takimi me familjarët dhe një ambient prindërimi në distancë. Në këtë ambient, kishte edhe një dhomë për takime speciale e cila ishte me kushte normale dhe e pastër, si dhe e pajisur me tualet dhe dush më vete. Ky ambient përdorej shumë rrallë nga të paraburgosurit, ndaj kjo dhomë shërbente edhe për takim me avokatët.

Gjithashtu, komunikimi me telefon i të paraburgosurve dhe i të dënuarve me familjarët e tyre bëhej normalisht, sipas numrit të telefonatave të parashikuara në rregullore që është 8 telefonata në muaj.

### **3. Kushtet materiale**

Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr është i klasifikuar me urdhër nr.8927/1 datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë “*Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*”, si “burg i sigurisë së ulët”, me një seksion siguri e ulët dhe një seksion burg i hapur për të dënuarit me vendim gjykate (gjysëm liri).

Sipas infrastrukturës, godina e banimit ishte me dy kate të ndara në dy seksione për çdo kat. Ndërkohë që çdo seksion ishte i ndarë në dy sektorë të tjerë. Pothuajse të gjitha dhomat kishin tualete dhe dushe brenda. Dhomat ishin të pajisura me materiale dhe orenditë e nevojshme për jetësë si shtretër, dyshekë, batanije, çarçafë, tavolina, dollape, stola për të gjithë të paraburgosurit.

Pastërtia dhe higjiena në korridoret dhe në dhomat e të paraburgosurve ishte e mirë. Dyshekët ishin në gjendje relativisht të mirë, ndërsa batanijet dhe çarçafët në një pjesë të tyre ishin sjellë nga familjarët e të paraburgosurve. Gjithashtu, Institucioni nuk kishte sistem ngrohje qëndrore, por në periudhën e dimrit të paraburgosurit ngroheshin me pajisje elektrike të siguruar nga familjarët e tyre.

Ndër problematikat kryesore që u konstatuan gjatë inspektimit të infrastrukturës ishte, prezenca e lagështirës e cila ishte shumë shqetësuese në katin e parë të godinës ku pothuajse i gjithë muri i jashtëm ishte tejet i amortizuar. Lagështira ishte prezente edhe në katin e dytë, kryesisht në pjesën e mureve ngjitur me tualetet. Kjo situatë, përbën një problem shqetësues dhe me pasoja të rënda në shëndetin e të paraburgosurve që jetojnë aty.

Ambienti i tualeteve dhe dusheve ishte i plotësuar me pajisjet dhe aksesoret e nevojshëm për plotësimin e nevojave vetjake të higjienës. Pjesa më e madhe e dhomave të banimit ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Dhomat e observim/veçimit ishin në katin e parë të godinës. Për të plotësuar funksionet e observimit dhe veçimit shërbente një godinë e përbërë nga gjashtë dhoma me kapacitet maksimal 12 persona. Sipërfaqja dhe kubatura e dhomave ishte për akomodimin e dy personave. Në sektorin e observim/veçimit, kishte një ambient që shërbente si tualet dhe

një ambient dushi për larjen e trupit, nga të paraburgosurit që ndodheshin aty për arsye të mospërshtatjes apo për masë disiplinore. Ambienti i tualetit dhe dusheve kishte ujë të ngrohtë dhe ishte i plotësuar me pajisje hidrosanitare. Ky ambient kishte lagështirë, por ajo ishte në nivele të ulta krahasuar me lagështirën në ambientet e paraburgimit.

Nga inspektimi i dhomave të banimit u konstatua se përmasat e dritareve ishin në përputhje me parametrat e nevojshëm dhe mundësonin futjen e dritës natyrale dhe ajrimin. Gjithashtu dhomat kishin hapësirë, por kubatura dhe sipërfaqja në 4 (katër) dhoma ku ishin sistemuar 6 të paraburgosur, nuk ishte e mjaftueshme për të përmbushur standardin, respektivisht jo më pak se 9 m<sup>3</sup> dhe jo më pak se 4 m<sup>2</sup> për çdo person.<sup>7</sup> Por, pavarësisht mbi popullimit, nga inspektimi rezultoi se, asnjë i paraburgosur nuk flinte me dyshek të vendosur në dysheme, por ishin të plotësuar me shtretër.

Gjatë vizitës u konstatua se, në ndryshim nga vizita e mëparshme, institucioni e kishte zgjidhur problemin e furnizimit me ujë me anë të rrjetit, duke vendosur disa çisterna në oborrin e institucionit. Megjithatë uji vazhdonte të ishte me orare, tre herë në ditë dhe këto orare ishin nga dy orë. Gjatë intervistave pati ankesa nga të burgosurit në lidhje me oraret e furnizimit me ujë, pasi kushtëzonte në kohë kryerjen e dusheve, larjen e ndërresave dhe enëve të ushqimit. Gjithashtu, pati edhe pretendime se uji ishte i papastër dhe i turbullt. Lidhur me këtë shqetësim, drejtuesi i institucionit sqaroi se kufizimet e vendosura për furnizimin me ujë, kishte të bënte me oraret e përcaktuara nga Drejtoria e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë, ndërsa uji i turbullt vinte për shkak të amortizimit të rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit.

Institucioni ishte i pajisur me lavanderi dhe lavatriçe profesionale, por pjesa më e madhe e të paraburgosurve dhe e të dënuarve i lanin vetë ndërresat e tyre. Nga ana e institucionit bëhej furnizimi i të paraburgosurve me detergjente të higjienës personale, sipas normave, por një pjesë e tyre merrnin detergjente shtesë nga familjarët e tyre, pasi ato ishin të pamjaftueshme.

Nga inspektimi që u zhvillua në kuzhinën e këtij institucioni, u konstatua se, ajo ishte në gjendje të mirë dhe e pajisur me orenditë e nevojshme bazë. Kuzhina ishte e lyster dhe e pastër nga ana higjienike. Punonjësit që punonin aty ishin të pajisur me libereza shëndetësore. Cilësia e ushqimit të gatuar në ditën e inspektimit dukej e mirë. Evidencat e gramaturave dhe menuja ditore mbaheshin konform rregullave dhe ishin të afishuara. Gjithashtu ishin të afishuara edhe menuja dhe gramatura përkatëse për diabetikët dhe personat e punësuar. Kampionet e ushqimit të gatuar një ditë më parë ruheshin për 24 orë në kushte frigoriferike dhe të kyçura. Nga intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit dhe të dënuarit rezultoi se nuk kishte ankesa për ushqimin. Pothuajse pjesa më e madhe e tyre e konsumonin ushqimin e gatuar në institucion.

Në kuzhinë, vazhdonte të ishte prezent shqetësimi i konstatuar dhe në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me mungesën e një aspiratori dhe ventilatori për largimin e avujve që krijoheshin gjatë gatimit, si dhe për ajrimin e ambientit.

#### **4. Regjimi dhe aktivitetet**

Aktivitetet në këtë institucion zhvilloheshin sipas një programi vjetor të sektorit psiko-social, i cili ishte i detajuar në javë dhe muaj dhe ishte i miratuar nga drejtuesi i Institucionit. Aktivitetet kryesore që zhvilloheshin në këtë institucion ishin ato me

---

<sup>7</sup>Neni 30, pika 1 e VKM nr. 437, datë 20.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve".

karakter kulturor, futbolla dhe ping-pongu. Në ambientet e katit të dytë në sektorin II gjendej dhe salla e aktiviteteve, e cila kishte disa funksione. Ajo shërbente si sallë aktivitetesh, kompjuterash dhe takimesh të përbashkëta. Gjithashtu brenda këtij ambienti, por në një dhomë më të vogël ndodhej edhe biblioteka ku kishte libra të cilët ishin kryesisht tituj të vjetër dhe ngelet për tu pasuruar më shumë me tituj të rinj të librave. Gjithashtu në këtë ambient zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta dhe ritet fetare.

Nga drejtuesi i institucionit ishte mundësuar edhe kryerja e aktiviteteve kulturore duke bashkëpunuar me grupe artistike të ndryshme, të cilët vinin dhe jepnin shfaqje për të paraburgosurit/dënuarit.

Ajrimi i personave që ndodhen në këtë institucion bëhej dy herë në ditë, dy orë paradite dhe një orë mbasdite. Ambienti i ajrimit kishte infrastrukturën e përshtatshme, pasi një pjesë e këtij ambienti ishte mbuluar, kryesisht për rastet kur kushtet atmosferike nuk ishin të favorshme për kryerjen e ajrimit.

Dosjet psiko-sociale të të paraburgosurve dhe të dënuarve plotësoheshin nga stafi i edukimit në mënyrë periodike. Punonjësit e edukimit bënë takime individuale me çdo të paraburgosur e të dënuar të cilat zhvilloheshin në sallën e këshillimit. Stafi i edukimit kishte zhvilluar diskutime për tema të ndryshme që kishin ndihmuar të paraburgosurit në procesin e përshtatjes në këtë institucion.

## **5. Shërbimet shëndetësore**

Organika e stafit mjekësor në këtë institucion ishte e plotësuar dhe përbëhej nga 7 (shatë) punonjës, një mjek, një stomatolog, një farmacist dhe 4 infermierë, me kohë të plotë. Shërbimi shëndetësor funksiononte me tre turne.

Nga intervistat me të paraburgosurit dhe të dënuarit u ngritën disa pretendime për shërbimin shëndetësor lidhur me vizitat e vonuara nga ana e mjekut të Institucionit. Por, nga intervista me stafin mjekësor dhe shënimet e mbajtura në dokumentacionin përkatës, rezultonte se, mjeku kryente vizita të rregullta në regjim dhe iu përgjigjej në kohë dhe në çdo rast kërkesave të të paraburgosurve/dënuarve. Në rastet kur nevojiteshin konsulta me mjekë të specializuar jashtë institucionit, ato realizoheshin menjëherë sipas procedurave dhe rregullave të sigurisë për këta persona.

Farmacia e këtij institucioni ishte në gjendje të rregullt dhe e pajisur me ilaçe për sëmundjet kronike dhe ato për sëmundjet akute. Furnizimi me ilaçe bëhej me skemën treshe, për të sëmurët kronikë ilaçet siguroheshin nga skema e ribursimit, për rastet e sëmundjeve të zakonshme furnizimi me ilaçe kryhej nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe, për rastet akute furnizimi me ilaçe bëhej menjëherë nga farmacisti dhe përballohej nga fondi që kishte në dispozicion ky institucion.

Sipas informacionit që u dha nga drejtori dhe mjeku rezultoi se në këtë institucion ishin 6 të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor dhe 9 persona diabetik. Gjithashtu kishte katër persona të cilët trajtoheshin me medikamentin “metadon”.

Trajtimi dhe ndjekja e të paraburgosurve me probleme të shëndetit mendor bëhej pas vizitave, konsultave dhe rekomadimeve të bëra nga mjeku psikiatër i Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve, i cili vinte mbi bazën e kërkesës së personelit mjekësor të këtij institucioni.



Dhoma e vizitave të mjekut ishte e rregullt, e pastër, e mirëmbajtur dhe e pajisur me një krevat vizitash, ndërsa në godinën e administratës dhoma e mjekut kishte një dollap ku mbaheshin ilaçet e urgjencës dhe një tjetër ku mbaheshin kartelat mjekësore të kyçura me çelës.

Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me autoklavë dhe instrumente dentare të cilat ishin të amortizuara, por sipas mjekut ishin funksionale. Shërbimi stomatologjik ofronte vetëm mjekime të urgjencës dhe ndonjë rast heqje dhëmbësh. Ndërkohë stomatologu nuk ofronte shërbim për mbushjen e dhëmbëve dhe të dhëmballëve, për shkak të mungesës të mjeteve dhe instrumenteve dentare. Në rastet kur kishte kërkesa dhe probleme për mbushje të dhëmballëve, personat e paraburgosur apo të dënuar dërgoheshin tek stomatologët privat. Kjo procedurë kërkonte më shumë kohë për t'iu kryer shërbimin personave, ndërkohë që rriste koston e administratës të institucionit për transportin dhe sigurimin e personit, por njëkohësisht rriste dhe koston e personit të paraburgosur që merrte shërbimin stomatologjik. Në rast se ky shërbim do t' u ofrohej të paraburgosurve brenda Institucionit, ky shërbim do të ishte më i shpejtë dhe pa kostot shtesë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri të vizitave të mjekut, regjistri themeltar i të paraburgosurve dhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve.

Institucioni kishte një autoambulancë, por nuk ishte funksionale dhe nuk ishte e pajisur me mjetet e nevojshme për dhënien e ndihmës së shpejtë.

Në përfundim të inspektimit, grupi inspektues administroi gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kishte të bënte me qëllimin e inspektimit, si dhe kopje të shkresave<sup>8</sup> të Drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me kërkesën për rikonstruksionin e tarracës të godinës së banimit të paraburgosurve dhe eliminimin e lagështirës në këto ambiente.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 9888 datë 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues ka këto kompetenca:*

*“b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues”*,

---

<sup>8</sup> Shkresë nr.1029 prot., datë 08.08.2018 dhe shkresë nr.1029/1 prot., datë 22.10.2018

## **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për reduktimin e mbipopullimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr;
2. Marrjen e masave të menjëhershme për kryerjen e hidroizolimit të taracës së godinës dhe rikonstruksionin e mureve të jashtme të dhomave të banimit e tualeteve në veçanti, për eliminimin e lagështirës, e cila ishte tej normave të lejuara;
3. Marrjen e masave të nevojshme në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Ujësjiellës Kanalizimeve, Tiranë, për riparimin e pjesëve të rrjetit të ujësjiellës që është amortizuar, për furnizimin me ujë të këtij Institucioni dhe eliminimin e problemit të furnizimit me ujë të turbullt;
4. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e dhomës së stomatologut me pajisjet dhe materialet dentare të nevojshme, në mënyrë që të ofrohet një shërbim efikas stomatologjik;
5. Marrjen e masave të nevojshme për të pajisur autoambulancën e institucionit me mjetet e nevojshme për dhënien e ndihmës së shpejtë;
6. Marrjen e masave të nevojshme për të vendosur në ambientet e kuzhinës, pajisjet për aspirimin dhe ventilimin e ajrit;
7. Marrjen e masave për lidhjen e kontratës të punës midis Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr dhe të paraburgosurve të punësuar.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFA**